



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETI DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1389/ Prot.

Tiranë, më 1.3.2023

Deklaratë për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2022

Unë i nënshkruari Erzen Tola, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe të koordinatorit të riskut të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, deklaroj se kam përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo-financiare të njësisë, si dhe pohoj që sistemi i kontrollit të brendshëm, i ngritur nga Titullari i Njësisë, mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë, në përputhje me përgjegjësitë që më janë caktuar sipas nenit 9 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.


Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues deklaroj se kam monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit gjatë vitit raportues 2022, nëpërmjet:

- Koordinimit të takimeve me drejtorët e drejtorive në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut.
- Këshillimit dhe dhënies së instruksioneve menaxherëve të tjerë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- Paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit tek Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të Ministrisë.

Dekloroj nën përgjegjësinë time se raporti bashkëlidhur kësaj deklarate, pasqyron në mënyrë të besueshme efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përfshin plan veprimin për trajtimin e mangësive të vërejtura në sistem për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

NËPUNËS AUTORIZUES



Shënim; Z. Alqi Kushi me shkresa nr. 5391/3 datë 04.10.2021 të Departamenti të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin e Sekretari i Përgjithshëm.

Ne vitin 2022_ Z. Alqi Kushi me shkresa nr. 5975/1 datë 25.10.2022 të Departamenti të Administratës Publike, është liruar nga pozicioni i rregullt drejtues i Sekretari i Përgjithshëm.

Ne vitin 2022_ Z. Erzen TOLA me shkresa nr. 5976/2 datë 25.10.2022 të Departamenti të Administratës Publike, është liruar nga pozicioni i i Drejtorit të Përgjithshëm dhe emërohet Sekretari i Përgjithshëm.



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETI DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ . 2023

RAPORT

“PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË MINISTRISË SË ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË PËR VITIN 2022”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2022, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në përmbushje të misionit dhe funksionimit të strukturave në varësi të saj, ka vazhduar të rrisë performancën e punës së saj, me qëllimin realizimin me sukses të objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2024, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”; Ligji nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar, Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021–2023”; Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”, Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me BE, Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, si dhe detyrime të tjera sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, realizimi i të cilave mbështetet tërësisht në Programin Buxhetor Afatmesëm 2022 -2024.

A) MJEDISI I KONTROLLIT

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Menaxherët e nivelit të lartë të njësive publike, shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontrolli në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit si dhe parimet e menaxhimit financiar, me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë janë krijuar tashmë sistemet e kontrollit të brendshme, të cilat janë gjithmonë në përmirësim duke synuar drejt përmbushjes optimale të objektivave.

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i cili është ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 08.05.2006, “Për krijimin e grupeve ministrore të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim, GSB1”, i ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm) në çdo njësi të qeverisjes qendrore.

- **Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave** “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- Struktura e Aparatit të MAS është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.
- **Rregullorja është ndryshuar dhe Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.352, datë 17.6.2019, është miratuar** “Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.
- **Rregullorja e Re është Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.689, datë 15.11.2022 është miratuar** “Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.

Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i sistemeve efikase të MFK-së, ndihmon në përshtatjen më të lehtë të njësisë ndaj ndryshimeve me të cilat ajo do të përballlet në mjedisin e jashtëm apo të brendshëm. Ministria e Arsimit dhe Sportit për vitin 2022, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas gjashtë programeve të miratuara, të listuar me poshtë:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”
2. Programi “Arsimi Bazë”
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Pergjithshëm”
4. Programi “Arsimi i Lartë”
5. Programi “Kërkimi shkencor”.
6. Programi “Për sportin dhe Rininë”.

Për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë është hartuar misioni, në gjashtë programet buxhetore të janë hartuar deklaratat e politikës së programit objektivat kryesore për sigurimin e një menaxhimi eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare për periudhën 2020-2022.

Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2019-2021, si dhe hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2022-2024, sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave , Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 74, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 te Ministrin te Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimi Plotësues, nr. 28, datë 10.7.2020 ”Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”, si dhe tavanet e miratuara me **Vendimit nr. 577, datë 22.7.2020** të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”.

Fondet e miratuara me ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2022, janë në shumën prej **45 miliard e 458 milion lekë**, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin për vitin 2022 arrijnë në **7.13%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2022 janë në nivelin **2.43%**.

Tabela nr. 1_ **Fondet e miratuara me ligjin nr.115/2022 “Për buxhetin e vitit 2022”**, në 000 lekë.

Tavanet e Fondeve Buxhetore te miratuara per vitin 2022, me ligjin e nr. 115/2021 "Per buxhetin 2022", (ne 000/LEK)									
Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Strukturuar ne % e fondeve 2021,	Ndryshimi ne 000 lekë fondeve 2022, ndaj vitin 2021	Ndryshimi ne % fondeve 2022, ndaj vitin 2021
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale				
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	41,207,347	3,931,000	320,000	4,251,000	45,458,347	100%	1,086,558	2.4%
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	736,320	85,000	0	85,000	821,320	1.8%	82,317	11.1%
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	23,649,517	1,208,000	0	1,208,000	24,857,517	54.7%	958,747	4.0%
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	6,701,600	1,112,000	0	1,112,000	7,813,600	17.2%	943,183	13.7%
09450	Arsimi Universitar	9,600,000	1,006,000	200,000	1,206,000	10,806,000	23.8%	- 234,485	-2.1%
09770	Fonde per Shkencen	396,240	250,000	100,000	350,000	746,240	1.6%	44,225	6.3%
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinise	123,670	270,000	20,000	290,000	413,670	0.9%	- 707,430	-63.1%

Fondet e buxhetit të rishikuar për vitin 2022, shtuar me **fondet grant të trashëguara** nga viti 2021, **pakësimet me Akti Normativ nr. 3, datë 16.3.2022**, pakësime prej **1 miliard e 678.8 milion lekë**, nga te cilat **600 milion leke pakesim shpenzimet kapitale si dhe 1miliar e 78.8 milion leke ne shpenzimet korenta) si dhe VKM nr. 193, date 30.3.2022, rishpendarje fondesh prej 12.3 milion lekë**, si dhe shtesa prej **160 milion leke miratuar meVendimit nr.330, datë 18.5.2022** të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022”, shtesa prej **785.95 milion leke** efektet financiare të pagave ne arsimin parauniversitar miratuar me VKM nr. 465 datë 6.7.2022, shtesa prej **1.2 miliard leke** miratuar me aktin normative nr.12, date 29.7.2022, **arrijnë në shumën prej 46 miliard e 947 milion lekë**, krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2022 në **7.49%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2022 janë në nivelin 2.56%, së bashku me shtesat e fondeve të rimara/trashëguara nga vitit 2022 nga IAL publike. Realizimi për periudhën 12-mujore 2022 është në shumën prej **44 miliard e 110 milion lekë**, ose në masën 94% e fondeve të planifikuara për 12-mujorin 2022. (tabela 1.2 sa vijon)

Tabela nr. 1.2 Fondet e buxhetit miratuar me ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, rishikuar me aktin Normative, si dhe VKM nr. , si dhe sipas programeve buxhetore ne 000 Leke;

Emri i programit	Buxheti Realizuar 12-M 2021	Buxheti Mirat 2022	Buxheti rishikuar + fonde grant te trasheguara 2022	Buxheti I rishik+ Gante te trasheguara per 12_M 2022	Buxheti realiz 12_M 2022 Grante te trasheguara	Struktura e fondeve per 12-mujorin 2022	Buxheti Realizuar 12_M_2022	Realizim ne % ndaj buxhetit te rishikuar
	Ne milion /lekë	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne milion /lekë	Ne %

1	Planif. menaxhim administrim	727.9	821.3	775.1	775.1	728.8	1.7%	728.8	94%	1.7%
2	Arsimi baze	23,774.3	24,857.5	25,422.5	25,422.5	25,207.5	54.2%	25,207.5	99%	57.1%
3	Arsimi i mesem pergjith	6,791.6	7,813.6	7,595.5	7,595.5	7,439.2	16.2%	7,439.2	98%	16.9%
5	Arsimi i larte	11,747.1	10,806.0	11,601.9	11,601.9	9,356.0	24.7%	9,356.0	81%	21.2%
6	Kerkimi shkencor	442.0	746.2	767.9	767.9	623.7	1.6%	623.7	81%	1.4%
7	Zhvillim i Sportit	1,100.2	413.7	784.6	784.6	755.0	1.7%	755.0	96%	1.7%
	Totali	44,583.1	45,458.35	46,947.521	46,947.52	44,110.2	100.0%	44,110.2	94.0%	100.0%

Fondet e rishikuar të buxhetit përfshirë fondet miratuara me ligjin vjetor ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, shtuar dhe fondet grant të trashëguara nga viti 2021, shtuar të ardhurat dytësore të IAL publike, pakësimet dhe shtesat e realizuara me Akti Normativ nr. 3, datë 16.3.2022, pakësimet prej 1 miliard e 678.8 milion lekë, nga te cilat 600 milion leke pakësim shpenzimet kapitale si dhe 1 miliard e 78.8 milion leke ne shpenzimet korente) si dhe VKM nr. 193, date 30.3.2022, rishpendarje fondesh brenda sistemit ne masen 12.3 milion lekë, shtesa e fondeve ne masen prej 160 milion leke miratuar me Vendimit nr.330, datë 18.5.2022 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, shtesa prej 785.95 milion leke efektet financiare te VKM nr. 465 datë 6.7.2022 Pagat ne arsimin parauniversitar, shtesa prej 1.2 miliard leke miratuar me aktin normative nr.12, date 29.7.2022, arrijnë në shumën prej **50 miliard e 264 milion lekë**, krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2022 në 7.78% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2022 janë në nivelin 2.66%, së bashku me shtesat e fondeve të rimara/trashëguara nga vitit 2022 nga IAL publike.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2022 është në shumën **prej 47 miliard e 427 milion lekë**, ose në masën 94% e fondeve të parashikuara për 12-mujorin 2022.

Tabela nr. 1.3 Fondet e buxhetit miratuar me ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, rishikuar me aktin Normative, si dhe VKM nr. **se bashku me te ardhura**, si dhe sipas programeve buxhetore ne 000 Leke;

Emri i programit	Buxheti Realizuar 12-M 2021	Buxheti Mirat 2022	Buxheti rishikuar + fonde grant te trasheguara 2022+ te Ardhura	Buxheti I rishik+ Gante te trasheguar + Te ardhurat per 12_M 2022	Buxheti realiz 12_M 2022 Grante te trasheguara	Struktura e fondeve per 12-mujorin 2022	Buxheti Realizuar 12_M_2022	Realizim ne % ndaj buxhetit te rishikuar		
	Ne milion /lekë	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne milion /lekë	Ne %		
1	Planif. menaxhim administrim	727.9	821.3	776.0	776.0	729.7	1.5%	729.7	94%	1.5%
2	Arsimi baze	23,774.3	24,857.5	25,474.1	25,474.1	25,259.1	53.3%	25,259.1	99%	53.3%
3	Arsimi i mesem pergjith	6,791.6	7,813.6	7,596.0	7,596.0	7,439.7	15.7%	7,439.7	98%	15.7%
5	Arsimi i larte	11,747.1	10,806.0	14,503.1	14,503.1	12,257.2	25.8%	12,257.2	85%	25.8%
6	Kerkimi shkencor	442.0	746.2	1,124.6	1,124.6	980.4	2.1%	980.4	87%	2.1%
7	Zhvillim i Sportit	1,100.2	413.7	790.5	790.5	760.9	1.6%	760.9	96%	1.7%
	Totali	44,583.1	45,458.35	50,264.331	50,264.33	47,427.0	100.0%	47,427.0	94%	100.0%

Tab_2 Fondet buxhetore sipas grup artikujve të realizuara për vitin 2021, fondet e miratuara me ligjin vjetor për vitin 2022, **plani i rishikuar + të ardhurat dytësore për 12 mujorin 2022**, si dhe realizimi sipas artikujve buxhetore faktik **për 12 mujorin 2022** në mijë lekë dhe në %.

Kodi	Emri	Buxheti REALIZUAR 12- M 2021+Te ardhurat	Buxheti Mirat 2021	Buxheti I rishik+ Te ardhurat per 12-M 2022	Buxheti I rishik+ Te ardhurat per 12-M 2022	Buxheti REALIZUAR 12- M 2022+Te ardhurat	Struktura e fondeve per 12-mujorin 2022+Te ardhurat	Buxheti Realizuar 12-M 2022+Te ardhurat
600-601	Paga+Sigurime Shoqërore	35,364,995	28,657,376	36,578,512.3	36,578,512.3	35,681,707	81%	98%
602-606	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,449,417	12,549,971	7,261,680.7	7,261,680.7	6,204,419	14%	85%
230-231	Kapitale Trupez Patrupëz	1,091,608	4,251,000	3,107,328.0	3,107,328.0	2,224,099	5%	72%
Totali kap 01-05	Korente dhe Kapitale	41,906,020	45,458,347	46,947,520.9	46,947,520.9	44,110,225	100%	94%
600-601	Shpenzime personeli ne %	84.4%	63.0%	77.9%	77.9%	80.9%	80.9%	
602-606	Mallra Shërbime të Tjera ne %	13.0%	27.6%	15.5%	15.5%	14.1%	14.1%	
230-231	Kapitale Trupez Patrup %	2.6%	9.4%	6.6%	6.6%	5.0%	5.0%	
600-601 kap 06	Paga+Sigurime Shoqërore	716,003.3	0.0	875,598.2	875,598.2	875,598.2	26.4%	100%
602-606 kap 06	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,240,258.7	0.0	1,501,242.5	1,501,242.5	1,501,242.5	45.3%	100%
230-231 kap 06	Kapitale të Trupez Patrupëz	720,780.6	0.0	939,969.6	939,969.6	939,969.6	28.3%	100%
	TOTAL 06	2,677,042.7	0.0	3,316,810.2	3,316,810.2	3,316,810.2	100%	100%
600-601 (kap01-	Paga+Sigurime Shoqërore	36,080,998	28,657,376	37,454,110	37,454,110	36,557,305	77.1%	98%

08)									
602-606 (kap 01-08)	Mallra dhe Shërbime të Tjera	6,689,676	12,549,971	8,762,923	8,762,923	7,705,661	16.2%	88%	
230-231 (kap 01-08)	Kapitale Trupez Patrup	1,812,389	4,251,000	4,047,298	4,047,298	3,164,069	6.7%	78%	
Totali (korente + kapitale + jobuxhetore)		44,583,063	45,458,347	50,264,331	50,264,331	47,427,036	100.0%	100.0%	
600-601	Shpenzime personeli ne %	80.9%	63.0%	74.5%	74.5%	77.1%			
602-606	Mallra Shërbime të Tjera ne %	15.0%	27.6%	17.4%	17.4%	16.2%			
230-231	Kapitale Trupez Patrup %	4.1%	9.4%	8.1%	8.1%	6.7%			

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, konfirmuar nga sistemi SIFQ i Ministrise se Financës.

Përgatitja e kërkesave buxhetore afatmesme 2023 – 2025, është realizuara mbështetur në objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të arsimit parauniversitar, strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, si dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim, synimeve, objektivate afatmesme treguesit e performancës të parashikuara për çdo program buxhetor, produktet, kostot për çdo produkt, përfituesit, sipas programeve buxhetore për periudhën afatmesme 2023-2025, në përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025.

Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2023-2025, është realizuara sipas objektivate të përcaktuara në si standardeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 130, datë 02.03.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”,

- **Urdhri nr. 206 datë 14.4.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit** "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj.
- **Urdhri nr.206/1, datë 14.4.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit** "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2023-2025 ", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj.
- **Hartimi i PBA 2023-2025. (Faza e parë)** Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2023-2025, Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2016-2021), sipas objektivate të përcaktuara në Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”; Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”; Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”. Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimi Plotësues, nr. 9, datë 28.2.2022 ”Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 130, datë 2.03.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”. **Shkresa dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 1514/2, date 02.05.2022;**

Hartimi i PBA 2023-2025. (Faza e dytë) Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2023-2025, Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2016-2021), sipas objektivate të përcaktuara në Vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”; Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”, Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimi Plotësues, nr. 9, datë 28.2.2022 ”Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 535, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përfundimater të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”. **Shkresa dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 1890/1, date 02.09.2022;**

Të gjithë drejtuesit titullarët, drejtues të nivelit të mesëm apo të ulët në njësi, megjithëse ka qënë një situata e vështirë pas COVID-2019, kanë përfutur trajnime afatshkurtra më qëllim që të janë të vetëdijshëm në lidhje me sistemin e menaxhimit financiar edhe kontrollit të brendshëm MFK-së, jo vetëm specialistët me qëllimi që të sigurojë:

- a) drejtimin e operacioneve në mënyrë të rregullt, etike, ekonomike, efikase dhe efektive;
- b) përqsajen e operacioneve me ligjet, rregulloret, politikat, planet dhe procedurat;

- c) ruajtjen e aktiveve dhe burimeve të tjera kundrejt humbjeve të shkaktuara nga keqadministrimi, shpenzime dhe përdorime të panevojshme, si dhe kundrejt parregullsisve dhe mashtrimit;
- d) forcimin e përgjegjësisë menaxheriale për një arritje të suksesshme të objektivave të vendosura;
- e) raportimin financiar në kohë dhe monitorimin e rezultateve të performancës.

<https://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/>

Gjatë vitit 2022 një nga problemet kryesore në kuadër të konsolidimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm ka qenë konsolidimi i strukturave, në mënyrë që ato të sigurojnë se detyrat, hierarkia, linjat e raportimit dhe përcaktimi i aktiviteteve të kontrollit janë ndarë siç duhet në mënyrë që të sigurohet përmbushja e objektivave afatgjatë, në zbatim të;

- **Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 te Këshillit të Ministrave** “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- **Struktura e Aparatit te MAS** është miratuar më Urdhrin e Kryeministrit nr. 163, datë 07.10.2017 "për miratimin e strukturës dhe organikës së MASR.
- Struktura e Aparatit te MAS është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.
- **Rregullorja është ndryshuar dhe Miratuar me Urdhrin e Ministrit** nr.352, datë 17.6.2019, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sporti", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.
- **Rregullorja e Re është Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.689, datë 15.11.2022** është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sporti", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.
- Urdhër nr. 234, datë 19.4.2019 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar".

Për institucionet e sistemit arsimor detyrat delegohen sipas kërkesave ligjore.

- Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë“;
- Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“;
- Ligji nr.115/2021, datë 16.12.2020 ”Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar;
- Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 te Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”,
- Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”,
- Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”;
- Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”.
- Vendimi nr. 98, datë 27.2.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”, ristrukturimin e ish-Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe ish-Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit (ISHA).
- Vendimin nr. 99, datë 27.2.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, janë ristrukturuar duke u **krijuar 52 Zyra Arsimore Vendore, 4 Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar , si dhe Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Tiranë.**
- Vendim nr.109, datë 15.2.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”.
- Vendimin nr.607 datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI);

Parimi 2 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Organi mbikëqyrës (Titullari / Nëpunësi Autorizues / Bordi apo Këshilli i drejtuesve në varësi të llojit të njësisë) demonstroi pavarësi në ushtrimin e detyrave dhe ushtron mbikëqyrje për zhvillimin dhe performancën e kontrollit të

brendshëm. Për vitin 2022, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) të vitit 2022, miratuar në zbatim të **Vendimit nr. 1121, datë 30.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021”**, si dhe **Vendimit nr. 850, datë 29.12.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në këshillin e ministrave gjatë vitit 2022”** (bashkëlidhur matrica më aktet ligjore dhe nënligjore, udhëzime si dhe urdhra të hartuara dhe miratuara për vitin 2022).

- Gjithsej për vitin 2022 janë miratuar 2 projekt ligje te cilat jane miratuar ne Kuvendin e Shqipërisë ,
- Janë realizuar dhe miratuar 38 Vendime të Këshillit të Ministrave;
- Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MASR-së, 32 **udhëzime** të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.
- Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MASR-së rreth **756**, urdhra të brendshëm me karakter të ndryshëm, të Ministrit të Arsimit, dhe Sportit;
- Është dhënë mendim për rreth **80**, projekt-akte të ardhura për mendim nga ministritë e linjës.
(bashkëlidhur kesaj deklarate, tabela analitike e akteve ligjore dhe nënligjore te miratuara ne vitin 2022).

Gjatë vitit 2022, janë realizuar raporte monitorimi për institucionet publike dhe private të arsimit të lartë “*Zbatimi i ligjshmërisë në institucionet e arsimit të lartë në shërbim të sigurimit të cilësisë dhe sigurimit të standardeve përmes shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të tij në institucion*”, raporte monitorimi për verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për certifikimin e kuotave për programet e studimit.

Për hapjen dhe riorganizimin e programeve të studimit me karakter profesional dhe programeve të cikleve të studimit për vitin akademik 2022-2023. Mbështetur në udhëzimin nr.1, datë 14.1.2020 të MASR “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”,

Për vitin akademik 2022-2023 janë paraqitur gjithsej 243 (dyqind e dyzet e tre) aplikime, si më poshtë:

I. Aplikime për hapje dhe/ose riorganizim të institucionit të arsimit të lartë/degëve të tyre/njësave kryesore

- 1. Aplikim për hapje kolegji universitar:** është paraqitur **1 (një)** aplikim, i cili është **rrëzuar**.
- 2. Aplikim për njësi kryesore:** janë paraqitur **4 (katër)** aplikime. Prej tyre **3 (tri)** janë aplikime për hapje dhe **1 (një)** është aplikim për riorganizim.

Nga këto, janë miratuar për t’u hapur **2 (dy)** njësi kryesore dhe është rrëzuar **1 (një)** aplikim për hapje.

Aplikimi i vetëm për riorganizim të njësisë kryesore, është **miratuar**.

- 3. Aplikim për hapje dege:** është paraqitur **1 (një)** aplikim, i cili është **rrëzuar**.

II. Aplikime për hapje dhe/ose riorganizim të programeve të studimit

1. Cikli I

- Bachelor: janë paraqitur **63 (gjashtëdhjetë e tre)** aplikime. Prej tyre, **55 (pesëdhjetë e pesë)** janë aplikime për hapje programi studimi dhe **8 (tetë)** janë për riorganizim programi studimi.

Nga këto, janë miratuar për t’u hapur **24 (njëzet e katër)** programe studimi dhe është miratuar riorganizimi për **8 (tetë)** programe.

Janë rrëzuar **31 (tridhjetë e një)** aplikime për hapje.

2. Program studimi i integruar i nivelit të dytë

- PIND: janë paraqitur **12 (dymbëdhjetë)** aplikime. Prej tyre, **11 (njëmbëdhjetë)** janë aplikime për hapje programi studimi dhe **1 (një)** është për riorganizim programi studimi.

Nga këto, janë miratuar për t’u hapur **4 (katër)** programe studimi dhe është **miratuar** i vetmi aplikim për riorganizim.

Janë rrëzuar **7 (shtatë)** aplikime për hapje.

3. Cikli II

- Master i shkencave: janë paraqitur **30 (tridhjetë)** aplikime. Prej tyre, **26 (njëzet e gjashtë)** janë aplikime për hapje programi studimi dhe **4 (katër)** janë për riorganizim.

Nga këto, janë miratuar për t’u hapur **21 (njëzet e një)** programe studimi dhe është miratuar riorganizimi për **4 (katër)** programe.

Janë rrëzuar **5 (pesë)** aplikime për hapje.

- Master profesional: janë paraqitur **37 (tridhjetë e shtatë)** aplikime. Prej tyre, **27 (njëzet e shtatë)** janë aplikime për hapje programi studimi dhe **10 (dhjetë)** janë për riorganizim.

Nga këto, janë miratuar për t’u hapur **14 (katërmëdhjetë)** programe studimi dhe është miratuar riorganizimi për **7 (shtatë)** programe.

Janë rrëzuar **13 (tremëdhjetë)** aplikime për hapje dhe **3 (tri)** për riorganizim.

- Master ekzekutiv: është paraqitur **1 (një)** aplikim, i cili është **miratuar**.
- Master i arteve: është paraqitur **1 (një)** aplikim për hapje, i cili është **rrëzuar**.

4. Cikli III

- Doktoratë: janë paraqitur **64 (gjashtëdhjetë e katër)** aplikime. Prej tyre, **16 (gjashtëmbëdhjetë)** janë aplikime për hapje programi studimi dhe **48 (dyzet e tetë)** janë për riorganizim (për shkak të ligjit).

Nga këto, janë miratuar për t'u hapur **3 (tri)** programe studimi dhe është miratuar riorganizimi për **17 (shtatëmbëdhjetë)** programe.

Janë rrëzuar **13 (trembëdhjetë)** aplikime për hapje dhe **31 (tridhjetë e një)** për riorganizim.

- Specializim Afatgjatë: janë paraqitur **6 (gjashtë)** aplikime, të gjitha për hapje programi studimi.

Nga këto, është miratuar **1 (një)** aplikim dhe **5 (pesë)** të tjerat janë rrëzuar.

Aplikimi i vetëm për riorganizim, është **miratuar**.

5. Programe studimi të karakterit profesional

Janë paraqitur **30 (tridhjetë)** aplikime për hapje programi studimi.

Nga këto, janë miratuar për t'u hapur **12 (dymbëdhjetë)** programe studimi dhe janë rrëzuar **18 (tetëmbëdhjetë)** aplikime.

III. Aplikime për mbyllje të programeve të studimit

Janë paraqitur gjithsej **15 (pesëmbëdhjetë)** aplikime për mbyllje programesh studimi dhe është **miratuar** aplikimi për secilin prej tyre.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2022, ka realizuar:

- në bashkëpunim me DAP, shpalljen e 14 pozicioneve vakante në shërbimin civil për institucionin dhe 13 vende vakante për Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë. Për këto procedura është bërë ndjekja e shpalljes së vendeve vakante në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe kryerja e praktikave për caktimin e punonjësve të MAS për procedurat në Komisionet e intervistimit për lëvizje paralele dhe pranimit apo ngritjes në detyrë të kandidatëve, në përputhje me aktet ligjore;
- 10 praktika pezullimi të statusit të nëpunësit civil, 3 praktika për procedurat e transferimit, si dhe 2 praktika transferimi të përhershëm në përfundim të periudhës së pezullimit;
- 1 (një) praktikë konfirmimi, si nëpunës civil, pas përfundimit të periudhës 1-vjeçare të provës në shërbimin civil;
- 79 praktika njoftimi dhe fillim të marrëdhënieve financiare të punonjësve për shkak të ristrukturimit, si dhe 9 punonjësve që kanë marrë aktin e emërimit nga DAP;
- përgatitja e 3 (tri) praktikave për punonjësit që mbushin moshën e pensionit;
- procedurat për risistemin e 5 nëpunësve gjyqfytues. Janë realizuar një sërë praktikash shkresore drejtuar DAP në lidhje me propozimin e pozicionit të punës për të 5 punonjësit gjyqfytues, si dhe aktrekomandimet për pozicionet e propozuara për 4 (katër) prej tyre;
- 11 praktika për emërime/lirime në pozicione administrative dhe politike, 4 lirime në pozicione të emëruar me kod pune;
- nënshkrimin e 7 kontratave të punës me praktikantë të punësuar nga Programi Kombëtar i Praktikave të Punës bazuar në Vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", të ndryshuar", dhe të 8 punonjësve me kontratë mbi numrin organik bazuar në vendimin nr. 35 datë 19.01.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrore".
- vlerësimin e **16 kandidatëve aplikues** dhe rankimin e tyre; përzgjedhjen e kandidatëve sipas profileve studimore të kërkuara; lajmërimin e **9 fituesve** dhe ndjekja e fillimit të programit.
- përgatitjen e **9 marrëveshjeve** me praktikantët e përzgjedhur për thirrjen VII në aparatin e ministrisë.
- **procedurat për shpallje dhe emërime sipas procedurës së parashikuar nga kodi i punës:**
 - ✓ për **1 pozicion Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë** e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ku për këtë procedurë është bërë administrimi i dokumentacionit të kandidatëve, asistimi i Komisionit për zhvillimin e testimit, intervistës së strukturuar dhe përgatitja e urdhrimit për emërimin në detyrë të kandidatit fitues;
 - ✓ për **4 akte lirimi të drejtorëve DRAP-ve**, 1 akt për ngarkimin e ushtrimit të funksioneve të drejtorit të përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe 4 akte emërimi të drejtorëve të DRAP-ve, deri në kryerjen e procedurave të konkurrimit;
 - ✓ për **1 (një) shpallje për shprehje interesi** lidhur me pozicionin Këshilltar i Ministrit në MAS.
 - ✓ për 3 (tre) thirrje për shprehje interesi për punonjës të Sekretariatit të Bologna Follow Up Group, si dhe janë hartuar 9 urdhra për emërim në detyrë dhe 4 urdhra për lirim nga detyra;
- **administrimin e dokumentacionit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit në Institucione të Arsimit të Lartë (IAL)** dhe janë kryer procedurat për emërimin e anëtarëve të Bordit të Administrimit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin për 12 (dymbëdhjetë) IAL-të publike;

- shqyrtimin e 121 (njëqind e njëzetë e një) dosjeve të kandidatëve për anëtar Bordi Administrimi, në 12 (dymbëdhjetë) Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, si dhe përgatitja e urdhrave për emërim në detyrë bazuar në vendimet e grupit të punës.
- ndjekjen e grafikut të trajnimeve pranë ASPA-s, për 18 punonjës, si dhe është kryer plani i nevojave për trajnimin e punonjësve të MAS;
- 1 (një) procedurë për shkelje disiplinore të një nëpunësi në MAS dhe 27 procedura për punonjës në institucionet e varësisë;
- ndjekjen e korrespondencës me ILDKPKI në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për procedurat e deklarimit para fillimit/pas largimit nga funksioni dhe periodik për 16 subjekte deklaruese (DPV), 4 subjekte deklaruese DPF dhe 2 subjekte deklaruese DPL;
- ndjekjen e procesit të vlerësimit të nëpunësit civil për 83 nëpunësve civile për periudhën 1 janar 2022- 30 qershor 2022 dhe 71 për periudhën korrik-dhjetor 2022.
- hartimi dhe miratimi i Rregullores së Brendshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në bazë të ndryshimeve strukturore.

II. VLERËSIMI I SISTEMIT TE MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, kontrolli i brendshëm është një ndër preokupimet kryesore të menaxhimit të lartë që trajtohen me prioritet nga Titullari i Ministrisë, drejtuesit e programeve buxhetore, nëpunësit autorizues të nivelit të dytë dhe nëpunësit zbatueses duke synuar një mbështetje të gjerë të gjithë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Mbështetur në detyrimet e përcaktuara në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si edhe udhëzimet e dhëna nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave, titullarët e të gjitha njësive janë përgjegjës, për krijimin dhe monitorimin e kontrollit të brendshëm brenda strukturës që drejtojnë.

Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë **duke filluar nga viti 2017-2018** e në vijim, nisur nga performanca pozitive, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, **jemi autorizuar, për të punuar me të drejtat të plota drejtpërdrejt në modulën e Buxhetit në Sistemin Informatike Financiar të Qeverisë (SIFQ)**, si Institucione Buxhetore të Nivelit të Parë, sipas hierarkisë me të drejtën e autoritetit për regjistrimin dhe aprovimin e transaksioneve lidhur me buxhetin, kontratave, pagesave, rishpërndarjeve të buxhetit, si dhe hedhjes në sistem SIFQ të fondeve të miratuara për vitin ushtrimor si dhe për dy vitet pasardhës.

Parimi 3 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Titullari / NA i njësisë publike duhet të krijojë një strukturë organizative, të caktojë përgjegjësi dhe të delegojë përgjegjësitë përkatëse për të arritur objektivat e njësisë, duke mirë-përcaktuar gjithashtu edhe linjat e raportimit.

Në **zbatim Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave** “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”. Struktura e Aparatit të MAS është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS. **Rregullorja është ndryshuar dhe Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.352, datë 17.6.2019, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore. Rregullorja e Re është Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.689, datë 15.11.2022 është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore. Urdhër nr. 234, datë 19.4.2019 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrove vendore të arsimit parauniversitar".**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit të brendshëm dhe **marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit**. Kjo rregullore përcakton rregulla mbi koordinimin e funksioneve, administrimin e dokumentacionit, pajisjeve, orarit zyrtar, rregullat e etikës dhe procedura të tjera të menaxhimit. Në rregullore ekzistojnë gjithashtu përgjegjësitë dhe detyrat e çdo drejtorie e sektori si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit.

Detyrat funksionale të çdo punonjësi janë përcaktuar në përshkrimet e punës, të cilat si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore dhe angazhimeve të reja ligjore që drejtoritë duhet të përmbushin në kuadër të funksionimit të tyre, kanë nevojë për rishikim të vazhdueshëm.

Kryesisht mjedisi i kontrollit ndikohet nga struktura organizative e cila është rishikuar për Aparatin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e sistemit arsimor parauniversitar, në mënyrë që nivelet hierarkike dhe ato të raportimit të jenë të qarta, me lidhje funksionale, si edhe çdo objektivi dhe detyrë të jetë e mbuluar plotësisht dhe pa dublime.

- Rishikimi i funksioneve, detyrave si dhe strukturave është miratuar me **Vendim nr.99, datë 27.2.2019** i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, për ristrukturimi i DAR/ZA-ve, si dhe Urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 234, datë 19.4.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrove vendore të arsimit parauniversitar".

- Rishikimi i funksioneve, detyrave si dhe strukturave, **Vendimin nr. 98, datë 27.2.2019** i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”, për ristrukturimi Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit (ISHA), si dhe miratimi i me **Urdhër nr. 69, datë 19.4.2019 të Kryeministrit** "Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)".
- Rregullorja është ndryshuar dhe Miratuar me **Urdhërin e Ministrit nr.352, datë 17.6.2019**, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.
- **Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021** te Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- Struktura e Aparatit te MASR është miratuar më Urdhërin e Kryeministrit nr. 163, datë 07.10.2017 "për miratimin e strukturës dhe organikës së MASR.
- Struktura e Aparatit te MAS është **miratuar më Urdhërin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021** "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit dhe përfshin vendosjen e objektivave që sigurojnë përmbushjen e misionit të çdo njësie, etikën personale dhe profesionale, strukturën organizative, filozofinë dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Njësitet publike demonstroi një angazhim për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje dhe në mbështetje të objektivave të njësive.

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Menaxhim Strategjik (GMS), i cili është ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.78, datë 08.05.2006, “Për krijimin e grupeve ministrore të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim, GSBI”, i ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm), në çdo njësi të qeverisjes qendrore, **si dhe me drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.**

Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2021-2023, është realizuara në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, nr. Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2023-2025, është realizuara sipas objektivave të përcaktuara në si standardeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 te Ministrit te Financave dhe Ekonomisë, si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 130, datë 02.03.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”;

- **Urdhërin nr. 206 datë 14.4.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit** "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj.
- **Urdhërin nr.206/1, datë 14.4.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit** "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2023-2025 ", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj.

